




AGJENCIA SHETËRORE E KADASTRËS

INDIKATORËT E PERFORMANCËS

(2006 - 2021)



Tiranë, 31.01.2022

Hyrje

Në shtator 2019, përfundoi procesi i krijimit të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, si rezultat i fuzionit të disa institucioneve ekzistuese të fushës së pronave.

Prej vitit 2020, filluam të përgatisim çdo fund viti një material që përmbledh **disa prej indikatorëve kryesorë të performancës** së institucionit. Kjo me qëllim që të evidentohen ndryshimet e sjella përmes këtij procesi, qoftë pozitive dhe qoftë negative.

- **Për fushën e veprimtarisë së ish-ZRPP**, indikatorët marrin në evidencë kryesisht periudhën 2015-2021, pasi vetëm për këtë periudhë mund të nxirren të dhëna përmes sistemit të trashëguar nga ish-ZRPP. Sdq, do thënë që të dhënat e trashëguara janë shumë fragmentare dhe të pasigurta, pasi në shumicën e rasteve ato ose nuk mblidheshin, ose mblidheshin me telefon.

- **Për fushën e veprimtarisë së ish-ALUIZNI-t**, të dhënat përfshijnë periudhën që nga viti 2006, pasi janë ekzistuese edhe të dhënat për atë periudhë.

- **Për fushën e veprimtarisë së AMTP-ve**, të dhënat janë shumë fragmentare, pasi në asnjë kohë nuk ka pasur të dhëna statistikore të besueshme, të qëndrueshme dhe të vazhdueshme as nga ish ZRPP dhe as nga Ministria e Bujqësisë.

Përgjithësisht janë zgjedhur **indikatorë që janë matur dhe të matshëm ndër vite**, për të pasur besueshmëri të procesit krahasimor.

Në këtë material, paraqiten kryesisht **indikatorë krahasimorë dhe jo thjesht sasiorë**, pasi vetëm të parët japin informacion rreth rezultatit të punës së institucionit.

Ky material do të vijojë të plotësohet vit pas viti duke shtuar edhe indikatorë të rinj, si psh. procesi i regjistrimit të pronës shtetërore, proces ky i lënë tërësisht pas dore për vite të tëra, etj.

Për vitin 2021, **indikatorët u ndikuan negativisht nga dy faktorë:**


- Covid-19. Virusi ngadalësoi në mënyrë të dukshme dhënien e shërbimeve, përfshiu një pjesë të punonjësve, etj.

- Problemet me sistemin dhe mbingarkimin e tij.

**INDIKATORËT HISTORIKË TË PERFORMANCËS
(2006-2021)**

- 1 - Numri i shërbimeve kadastrale në vite.**
- 2 - Kohëzgjatja e dhënies së shërbimit.**
- 3- Aplikime pa përgjigje.**
- 4 - Kohëzgjatja e vonesave të theksuara në përgjigje.**
- 5 - Aplikimet në portalin e-Albania.**
- 6 - Numri i Certifikatave të pronësisë.**
- 7 - Rivlerësimi i pasurive të paluajtshme.**
- 8 - Regjistrimi i AMTP-ve.**
- 9 - Legalizimet.**
- 10 - Përrjashtimet nga procesi i legalizimit.**
- 11 - Legalizimi i pallateve të braktisura nga ndërtuesit.**
- 12 - Regjistrimi i Lejeve të Legalizimit.**
- 13 - Formalizimi i objekteve të ndërtuara para vitit 1991.**
- 14 - Proceset gjyqësore.**
- 15 - Apelimet.**
- 16 - Portali i Bashkëqeverisjes.**
- 17 - Kalimi i së drejtës së pronësisë mbi parcelën ndërtimore.**
- 18 - Të ardhurat / shpenzimet.**
- 19 - Sistemi i zyrave.**
- 20 - Përmirësim / Përditësimi i blloqeve kadastrale.**
- 21 - Regjistrimi fillestar.**
- 22 - Ngarkimi i pasurive në sistemin ALBSCAD.**
- 23 - Risitë e Vitit 2022.**


SHËRBIMET KADASTRALE



1. Numri i shërbimeve kadastrale në vite.

Në vetvete numri i shërbimeve kadastrale të kryera (ndaj qytetarëve dhe institucioneve) nuk është tregues i mirëfilltë performance nga njëri vit në tjetrin, por jep në mënyrë sasiore aktivitetin e kryer nga Institucioni. **Sdq, volumi i punës shpreh edhe trendin e përgjithshëm të nevojave të popullsisë dhe aftësinë përgjigjëse të Institucionit.** Në numrin e shërbimeve kadastrale nuk përfshihen numri i përgjigjeve të kthyer për plotësim dokumentacioni (ose ndryshe akte verifikimi).

Viti	Nr. Shërbime:
2018	735,232
2019	765,223
2020	883,875
2021	1,514,985



Në shifrën e vitit 2020 nuk janë përfshirë shërbimet pa pagesë të dhëna ndaj OFL (rreth 60.000 shërbime), si dhe shërbimet dhënë në kuadër të procesit të rindërtimit (rreth 140.000 shërbime).

Parashikimi për një rritje e numrit të shërbimeve, si rezultat i shtimit të fluksit të aplikimeve për rivlerësimin u tejkalua.

Koment: Me mbylljen e vitit 2021, konstatohet që ky vit ka një trend rritës të numrit të shërbimeve ndaj qytetarëve, në krahasim me vitet e kaluar, konkretisht 71% më shumë se viti 2020.

Shënim: Të dhënat janë gjeneruar në datën 19.01.2022.


2. Koha mesatare e dhënies së shërbimit.

Ky indikator përcakton **kohën mesatare (në ditë) të dhënies së shërbimit nga sportelet e shërbimit të kadastrës**. Indikatori është përcaktuar si diferencë midis ditës së aplikimit nga ana e qytetarit dhe ditës së marrjes së shërbimit.

Janë përfshirë në llogaritje të gjitha aplikimet e kryera brenda një viti, si ato me përgjigje ashtu edhe aplikimet pa përgjigje.

Për aplikimet që rezultojnë pa përgjigje në atë vit, si datë përgjigje, është vendosur data 31 Dhjetor e po atij viti (psh. shifra 101 e vitit 2015 tregon diferencën e ditëve nga data kur është kthyer përgjigje deri në datën e aplikimit).

Koha mesatare e shërbimit							
Viti	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021
Ditë kalendarike	101	82	103	81	95	24.2	23.3



Koment: Ky është një nga indikatorët më të rëndësishëm të performancës së një institucioni që ka si bazë dhënien e shërbimeve ndaj qytetarëve. Është kaluar nga një maksimum prej një mesatareje prej 101 ditësh (2017) në një mesatare prej 23.3 ditësh (2021).


Ngritja e kësaj kurbe në vitin 2019, është shkaktuar kryesisht në muajt e tranzicionit të fuzionit të institucioneve.

Shënim: Të dhënat janë gjeneruar në datën 19.01.2022.

3. Aplikime pa përgjigje.

Ky indikator paraqet ecurinë e numrit të aplikimeve të qytetarëve që nuk kanë marrë përgjigje për aplikimet e bëra prej tyre. E shprehur kjo, në shifra dhe në përqindje, në raport më numrin e përgjithshëm të aplikimeve të atij viti.

Viti:	Aplikime pa përgjigje
2015	81,746
2016	74,713
2017	124,517
2018	98,057
2019	77,926
2020	3,559
2021	4,763




Koment: Është e rëndësishme të theksojmë këtu që këto shërbime të pakryera janë të gjitha të parapaguara nga qytetarët, megjithëse nuk e kanë marrë kurrë shërbimin. Kjo do të thotë që për 5 vjetët 2015-2019, figurojnë rreth 450.000 shërbime të paguara dhe të padhëna, me një vlerë prej rreth 10 milion USD.

Praktikisht **kjo mund të quhet vjedhje shtetërore** dhe është një nga arsyet e namit shumë të keq të zyrave të ish ZRPP.

Duke filluar nga vitit 2020 tashmë këto nuk janë më aplikime që nuk e kanë marrë asnjëherë shërbimin, por janë shërbime me vonesë, pra shërbime që nuk janë dhënë në afat.

Shënim: Të dhënat janë gjeneruar në datën 19.01.2022.

Viti:	Aplikime pa përgjigje në %
2015	30,0%
2016	24,4%
2017	34,2%
2018	31,5%
2019	27,1%
2020	1,2%
2021	1,1%



Koment: Një nga **indiktorët më të rëndësishëm të performancës** së një institucioni që ka si bazë dhënien e shërbimeve ndaj qytetarëve. Është kaluar nga një maksimum prej 30% të aplikimeve pa përgjigje (2015), në një mesatare prej 1,1% aplikime pa përgjigje (2021).

Ngritja në 27,1% e kurbës në vitin 2019, është shkaktuar kryesisht në muajt e tranzicionit të fuzionit të institucioneve.


Shënim: Të dhënat janë gjeneruar në datën 19.01.2022.

4. Kohëzgjatja e vonesave të theksuara, në përgjigje.

Ky indikator analizon vetëm ato aplikime të qytetarëve, për të cilët ka pasur vonesa të mëdha (mbi 90 ditë nga dita e aplikimit), e shprehur në përqindje si raport midis numrit total të aplikimeve me numrin e aplikimeve me vonesa mbi 90 ditë.

Ky indikator nuk përfshin aplikimet që nuk kanë marrë përgjigje asnjëherë.

Viti:	Më shumë se 90 ditë:
2015	7.1%
2016	4.1%
2017	7.0%
2018	5.4%
2019	7.5%
2020	2.5%
2021	1.0%



Koment: Një nga indikatorët më të rëndësishëm të performancës së një institucioni që ka si bazë dhënien e shërbimeve ndaj qytetarëve.

Është kaluar nga një maksimum prej 7.1% të aplikimeve me përgjigje të kthyer me vonesa më shumë se 90 ditë (2015), në një mesatare prej 1.0% të aplikimeve me vonesa mbi 90 ditë (2021).

Ngjitja 7.5% e kurbës në vitin 2019, është shkaktuar kryesisht në muajt e tranzicionit të fuzionit të institucioneve.

5. Aplikime nëpërmjet portalit qeveritar e-Albania.

Ky indikator analizon numrin e aplikimeve të kryera në Portalin Qeveritar e-Albania nga qytetarët, për periudhën 2016 deri më 2021. Kjo pasi në vitin 2016 është mundësuar për herë të parë kryerja e aplikimit edhe nëpërmjet Portalit Qeveritar e-Albania për 51 Shërbimet që ofronte ish-ZRPP.

Viti:	Nr. Aplikimeve nga e-Albania:
2016	29
2017	634
2018	997
2019	902
2020	154,338
2021	189,558



Koment: Në zbatim të UKM Nr.153 dt .25.11.2019, Ligjit 111/2018 "Për Kadastrën", Ligjit 20/2020 "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në RSH", si dhe akteve nënligjore, për vitin 2020 u mundësua kryerja e të gjithë aplikimeve vetëm online nëpërmjet Portalit Qeveritar e-Albania si dhe sistemeve të tjera si Dhoma Kombëtare e Noterisë, ASHK për Institucione (nga nëntor 2020) etj., duke mënjanuar rradhët nëpër sportele si dhe duke rritur performancën e ofrimit të shërbimeve kundrejt Qytetarëve dhe uljen e kohës së marrjes së përgjigjes.

Ky indikator tregon numrin e aplikimeve të kryera vetëm nëpërmjet portalit e-albania.


*Aplikimet u referohen vetëm aplikimeve të paguara.

Në numrin e mësipërm nuk janë përfshirë një numër i lartë aplikimesh që kryhen dhe nëpërmjet sistemit të noterëve NISA (me 236,310 aplikime gjatë vitit 2021), si dhe modulit "ASHK për institucione", që filloi funksionimin për herë të parë në nëntor të vitit 2020 (me 7,747 aplikime gjatë vitit 2021). Gjatë vitit 2020 aplikime nga sisteme të tjera, përveç nga e-albania janë 140.808 aplikime.

Në total aplikime 2020 = 295,146 aplikime.

Në total aplikime 2021 = 433,615 aplikime.

Viti:	Nr. Total Aplikime
2020	295,146
2021	433,615




Koment: Numri i përgjithshëm i aplikimeve gjatë vitit 2021 është 47% më i lartë se numri i përgjithshëm i aplikimeve gjatë vitit 2020.

Shënim: Të dhënat janë gjeneruar në datën 19.01.2022.

6. Numri i Certifikatave të pronësisë.

Ky indikator analizon numrin e certifikatave të pronësisë të lëshuara nga ish ZVRPP-të dhe ASHK, përgjatë viteve 2015 – 2021.

Viti:	Nr. i certifikatave të pronësisë:
2018	127,220
2019	134,736
2020	144,801
2021	241,640



Koment: Në zbatim të UDP të ASHK-së, Nr. 1361 datë 12.05.2020 “Për nënshkrimin elektronik të akteve kadastrale për shërbimet e ofruara nga ASHK dhe miratimin e procedurës së punës”, të gjitha aktet kadastrale që ofron ASHK (ku bëjnë pjesë dhe certifikatat e pronësisë), lëshohen vetëm me nënshkrimin dhe vulën elektronike.

Numri i certifikatave të pronësisë të lëshuara nga ASHK gjatë vitit 2021 është 67% më i lartë se numri i certifikatave të lëshuara gjatë vitit të kaluar 2020.

Duhet pasur parasysh se deri në vitin 2020, certifikatat e pronësisë plotësoheshin e lëshoheshin me dorë, si rrjedhim saktësia e numrit të tyre deri në vitin 2020, nuk është 100% e saktë.

Shënim: Të dhënat janë gjeneruar në datën 19.01.2022.

7. Rivlerësimet e pasurive të paluajtshme ndër vite.

Procesi i rivlerësimit të pasurive parashikon që të gjithë individët që kanë në pronësi pasuri të paluajtshme, kanë të drejtë që që nga data e hyrjes në fuqi të ligjit përkatës, të bëjnë rivlerësimin e pasurisë së tyre me vlerën e tregut. Aktualisht ky proces kryhet në bazë të ligjit 90/2019, "Për rivlerësimin e pasurisë së paluajtshme", të ndryshuar me aktin normativ Nr. 35 datë 24.12.2021, i cili e ka shtrirë afatin e zbatimit të këtij ligji deri në datën 31 prill 2022.

Është hera e tretë që ky proces, i konsideruar dhe si "amnisti", zbatohet për rivlerësimin e pasurive të paluajtshme:


Hera e parë 2011-2013, ku procesi i rivlerësimit dhe taksimit të tij ka qenë me 1%;

Hera e dytë 2016-2017, ku procesi i rivlerësimit dhe taksimit të tij ka qenë me 2%;

Hera e tretë 2020-2022 ku procesi i rivlerësimit dhe taksimit të tij kryhet me 3%.

Viti	Rivlerësime pasurie:
2011	1,602
2012	12,986
2013	16,457
2016	23,303
2017	59,555
2020	61,620
2021	70,424

RIVLERËSIMET E PASURIVE TË PALUAJTSHME NDËR VITE



Koment: Rritja e numrit të rivlerësimeve çdo herë që është marrë kjo nismë, flet për njohjen dhe kuptimin gjithnjë e më të madh nga ana e publikut të vlerës së këtij operacioni.

8. Certifikimi i AMTP-ve.

Procesi i regjistrimit të tokës bujqësore është një nga detyrat më të mëdha që i dalin Kadastrës Shqiptare mbi bazën e ligjit 20/2020.

Por aktualisht është e pamundur të nxirren të dhëna pasi qoftë nga Ministria e Bujqësisë dhe qoftë nga ish ZRPP nuk janë mbajtur evidenca mbi ecurinë e këtij procesi në vite.

Ndërkaq, procesin e kanë komplikuar edhe faktorë të tjerë si, ndryshimet e shpeshta ligjore ndër vite, zgjatja e procesit jashtë çdo limiti kohor për gati 3 dekada, përfshirja e shumë institucioneve të ndryshme dhe të ndryshumeshme kohë pas kohe, etj.

Në përgjithësi konsiderohet të jenë dhënë në total rreth 454.500 AMTP:

Janë rreth 20.000-25.000 AMTP të reja që parashikohen për t'u plotësuar (që nuk janë pajisur me AMTP në bazë të ligjit 9948/2008 dhe ligjit 171/2014, afati zbatimit të të cilave ka përfunduar në 31.12.2019).

Ritmi i pajisjes me AMTP nga Bashkitë ka qenë shumë i ulët, rreth 1 mijë AMTP në vit.


Tabela me AMTP të plotësuar sipas Bashkive dhe informacioni nga DAMT.

VITI:	Nr. I AMTP:
1992-2008 (info nga DAMT)	44.7312
2013-2019 (info nga Bashkitë)	7.280
TOTAL AMTP	454.592

Certifikimi i AMTP-ve.

VITI	Nr. Certifikatave për tokën bujqësore
2019	8,311
2020	18,576
2021	22,400

Certifikata për tokën bujqësore
2019-2021



Koment: Megjithë rëndësinë e procesit të regjistrimit të tokës bujqësore, për shkak të mungesës së të dhënave historike si nga ana e Ministrisë së Bujqësisë, nga ana e Bashkive dhe Qarqeve, si edhe nga ana e ish-zyrave të ZRPP, ka qenë e pamundur të ndërtohet një pasqyrë e qartë e vijimit të këtij procesi ndër vite.

SHËRBIMET E LEGALIZIMIT




9. Legalizimet.

Ky indikator mat numrin e lejeve të legalizimit, të dhëna në vite nga ish-ALUIZNI dhe sot nga ASHK.

Në numrin e përgjithshëm të Lejeve të legalizimeve, nuk janë përfshirë legalizimet e apartamenteve / njësive të shërbimit të pallateve të braktisura.

Tabela për progresivin e lejeve të legalizimit.

PERIUDHA:	LEJE LEGALIZIMI 2006 - 2021
2006-2009	1.583
2010	3.404
2011	7.410
2012	13.179
2013	21.750
2014	37.044
2015	61.792
2016	110.143
2017	136.594
2018	166.745
2019	178.763
2020	199.754
2021	224.771



Në këtë grafik, nuk janë përfshirë njësitë (apartamente / njësi shërbimi) të legalizuara përmes VKM 19/2017 për legalizimet e pallateve të braktisura.

Leje Legalizimi sipas viteve.

VITI:	LEJE LEGALIZIMI:
2006-2009	1.583
2010	1.821
2011	4.006
2012	5.769
2013	8.571
2014	15.294
2015	24.748
2016	48.351
2017	26.451
2018	30.151
2019	12.018
2020	20.991
2021	25.017
Total	224.771

LEJET E LEGALIZIMIT SIPAS VITEVE
PERIUDHA 2006- 2021




Koment: Rënia e theksuar e numrit të legalizimeve në vitin 2019, erdhi si pasojë e miratimit në janar të atij viti të një ndryshimi në Ligjin e taksave vendore, që kushtëzonte legalizimin me pagesën paraprake të taksës së ndikimit në infrastrukturë. Kjo gjë u ndreq vetëm në gusht 2020 dhe dha menjëherë efekt në rritjen gati në dyfishim të numrit të legalizimeve. Numri i vendimeve të legalizimit gjatë vitit 2021 është 19% më i lartë se ato të vitit 2020.

10. Përjashtimet nga procesi i Legalizimit të ndërtimeve pa leje.

Ky indikator mat numrin e vendimmarrjeve për moslegalizim të ndërtimeve informale, të marra në vite nga ish-ALUIZNI dhe sot nga ASHK.

VITI:	VENDIME PËR MOSLEGALIZIM:
2006-2013	1,019
2014	356
2015	238
2016	405
2017	293
2018	583
2019	210
2020	94
2021	15



Koment: Numri i vendimeve për moslegalizim të ndërtimit informal është kryesisht në varësi të kërkesave të paraqitura nga institucionet shtetërore.

11. Legalizimi i pallateve të braktisura nga ndërtuesit.

Procesi i legalizimit të pallateve, ndahet në dy kategori, në pallatet e zakonshme të pabanuara dhe në pallatet e braktisura nga ndërtuesit dhe të banuara. Problematika e trashëguar ka qenë kjo e dyta. Në këtë kategori, përfshihen pallatet pa leje ndërtimi, me shkelje të lejes së ndërtimit, rastet kur ndërtuesi ka falimentuar apo e ka braktisur procesin e legalizimit, etj dhe ndërkohë objekti është i banuar.


Të dhënat:

Në total 959 pallate të formalizuar gjatë periudhës 2014- 2021.

SIPËRFAQE BANIMI (M2)	1,805,549
SIPËRFAQE SHËRBIMI (M2)	626,634
SIPËRFAQE TOTALE	2,432,183

VITI	Pallate të legalizuara:
2006 - 2013	167
2014	22
2015	105
2016	82
2017	107
2018	79
2019	83
2020	158
2021	156
TOTAL	959

Pallate të braktisur të legalizuar ndër vite
periudha 2006 - 2021



Koment: Për zonat urbane, ky proces është një histori suksesi, me të njëjtën rëndësi si vetë procesi i legalizimeve për zonat rurale.

12. Leje Legalizimi të regjistruara.

Regjistrimi dhe certifikimi i lejeve të legalizimit, ka qenë vazhdimisht një çështje mosmarrveshje midis ALUIZNI-t dhe ZRPP. Kjo për faktin se vit pas viti në ZRPP ishte krijuar një stok që sa vinte dhe shtohej i lejeve të legalizimit të dhëna.

Viti:	Leje legalizimi:	Leje legalizimi të regjistruara
2015	24,748	9,001
2016	48,351	15,264
2017	26,451	16,886
2018	30,151	24,332
2019	12,018	30,386
2020	20,991	22,494
2021	25,017	47,026
TOTAL	187,727	165,389

Leje Legalizimi të dhëna dhe Leje Legalizimi të Regjistruara
periudha 2015 - 2021



Koment: Për herë të parë në vitin 2019, 2020 dhe 2021, numri i lejeve të regjistruara ka filluar të kalojë numrin e lejeve të dhëna, duke ardhur gjithnjë në rritje. Kjo me qëllimin për të evaduar stokun e legalizimeve të paregjistruara.

Numri i lejeve të legalizimit të regjistruara gjatë vitit 2021 është 110% më i lartë se numri i lejeve të regjistruara gjatë vitit të kaluar 2020.

13. Formalizimi i objekteve të ndërtuara para vitit 1991.

Përfshin formalizimin e banesave të vjetra të ndërtuara në të gjitha epokat përpara vitit 1991 dhe të cilat nuk kanë qenë regjistruar asnjëherë në ZRPP.


Procesi ka filluar në vitin 2012 nga Bashkitë, mbi bazën e VKM nr. 608/2012, "Për përcaktimin e procedurës ...". Me VKM 442/2018 "Për përcaktimin e procedurës së kalimit ...", kjo procedurë që ishte funksion i Bashkive, kaloi në ngarkim të ish-ALUIZNI-t. Sot procesi kryhet nga ASHK.

Me hyrjen në fuqi të VKM-së Nr. 827 datë 30.09.2020 "Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për miratimin e dokumentit të pronësisë, të objekteve pa titull pronësie, trojeve të tyre funksionale dhe të oborreve në përdorim", VKM 442 është shfuqizuar.

Tabela e objekteve të formalizuara nga Bashkitë dhe ASHK sipas viteve:

VITI:	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021
BASHKITË	120	110	100	80	120	100	110	-	-	-
ASHK	-	-	-	-	-	-	-	249	1.521	2.211

Formalizimi i objekteve të ndërtuara para vitit 1991
Periudha 2012 - 2021



Koment: Për periudhën 2012-2018, që ky proces u ka qenë deleguar Bashkive, mund të thuhet se ka qenë praktikisht i braktisur, me një mesatare prej rreth 100 objektiv të formalizuara në vit në rang Republike.

Që prej vitit 2020, që procesi i ka kaluar ASHK-së, ritmet janë mbi 10-fishuar dhe parashikohet të mbahet një normativë vijuese prej 20-fishi.


Numri i objekteve të ndërtuara para vitit 1991 të formalizuara gjatë vitit 2021, është 45% më i lartë se numri i objekteve të formalizuar vitin e kaluar 2020.

14. Proceset gjyqësore.

Ky indikator ka për qëllim që, në gjyqet ku ASHK është palë, të tregojë trendin e gjyqeve të fituara në raport me numrin e gjyqeve të humbura.

Viti	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021
Të zhvilluara	949	806	1033	1263	610	472	736
Të fituara	497	423	565	671	334	323	554
Raporti në %	52.4	52.5	54.7	53.1	54.8	68.4	75.2

Trendi i çështjeve të fituara në Gjykatë
Periudha 2015 - 2021
Raporti në %



Koment: Numri i çështjeve gjyqësore të fituara në gjykatë në vitin 2021 është 72% më i lartë se numri i çështjeve gjyqësore të fituara vitin e kaluar 2020.

Rritja e numrit të çështjeve gjyqësore të fituara nga institucioni, ka lidhje direkte:


-me përgjegjshmërinë e përfaqësuesve të institucionit në gjykim; dhe

-me saktësinë e vendimarrjeve të institucionit që janë kundërshtuar në gjykatë.

15. Apelimi.

Ky indikator ka për qëllim të tregojë trendin e ankimeve administrative ndaj vendimarrjeve të institucionit.

Viti	(ish ALUIZNI)	(ish ZRPP)	ASHK	TOTAL
2017	123	3.866	-	3.989
2018	251	6.000	-	6.251
2019	212	-	545	757
2020	-	-	1.074	1.074
2021	-	-	1.296	1.296



Koment: Ky indikator monitorohet për herë të dytë.

Ulja e numrit të ankimeve administrative, ka të bëjë direkt me **rritjen e saktësisë së vendimarrjeve të institucionit**, gjë që ul mundësinë dhe nevojën për ankimim administrativ.

16. Portali i Bashkëqeverisjes.


Portali “Shqipëria që duam” është një platformë e hapur komunikimi dhe ndërveprimi, e cila ofron një mënyrë komunikimi me publikun, më të shpejtë e më efikase se letrat e shkruara me dorë. Portali ofron mundësinë e marrjes së përgjigjes në një kohë prej 10 ditë pune.

Portali ka filluar funksionimin në Nëntor 2017 dhe administrohet nga Zyra e Bashkëqeverisjes, Agjencia për Dialog e Bashkëqeverisje, në Kryeministri.

Ky indikator paraqet trendin e numrit të ankesave të drejtuara në Portalin e Bashkëqeverisjes, sipas viteve për ish-ZRPP, ish-ALUZINI dhe që nga muaji Qershor 2019, për ASHK-në.

ANKESA BASHKËQEVERISJA	
VITI	NR. ANKESA
2018	6,073
2019	10,163
2020	7,182
2021	6,991

**TRENDI I ANKESAVE NË PORTALIN E BASHKËQEVERISJES
2018- 2021**



Koment: Ky indikator monitorohet për herë të dytë.

Ulja e numrit të ankimimeve në portalin “Shqipëria që duam”, ka të bëjë direkt me rritjen e produktivitetit të institucionit.


Numri i ankesave në portalin e bashkëqeverisjes gjatë vitit 2021 është 3% më i ulët krahasuar me numrin e ankesave në këtë portal përgjatë vitit të kaluar 2020.

17. Procesi i kalimit të së drejtës së pronësisë mbi parcelën ndërtimore.

Evidenca e VKM-ve për kompensimin e pronarëve për sipërfaqet takuese të zëna nga ndërtimet informale, sipas viteve.

VITI	Nr. i pasurive të trajtuara
2008	31
2009	232
2010	75
2011	291
2012	199
2013	335
2014	50
2015	415
2016	493
2017	231
2018	731
2019	1,024
2020	1,933
2021	1,443
TOTALI	7,483

Grafiku i mëposhtëm, paraqet numrin pasurive të trajtuara sipas VKM-ve përkatëse për kompensimin e pronarëve për sipërfaqet takuese të zëna nga ndërtimet informale.



Koment: Të ardhurat që sigurohen nga ky proces shkojnë kryesisht për shpërblimin e ish-pronarëve dhe përbëjnë burimin kryesor në rang vendi për procesin e kompensimit të tyre.


18. Të ardhurat e realizuara në vite.

Të dhënat përfshijnë të ardhurat e realizuara nga ASHK që nga periudha e krijimit të saj (Mars 2019), si dhe institucionet e përfshira tashmë në të, ish ZRPP dhe ish ALUIZNI, sipas viteve përkatëse.

Të Ardhurat dhe shpenzimet në nivel kombëtar, për periudhën 2008 - 2021:

VITI:	Të Ardhuara Total	Shpenzimet total
2008	560,540,449	892,933,064
2009	719,900,381	1,083,193,461
2010	658,099,854	1,013,134,675
2011	786,329,537	952,880,642
2012	1,505,373,515	943,629,658
2013	1,578,304,117	1,060,495,458
2014	1,517,810,922	1,364,336,237
2015	2,505,788,404	1,972,673,124
2016	2,289,443,408	2,532,732,874
2017	2,329,824,961	2,081,156,625
2018	2,152,790,125	1,978,301,869
2019	1,997,513,905	2,029,924,073
2020	2,266,006,782	2,125,218,989
2021	3,211,099,946	2,118,925,204

Të ardhura dhe shpenzime në vite
2008-2021



Komente: Ky indikator në vetvete nuk flet për performancën e Institucionit.

- Për periudhën 2008-2012, shpenzimet tejkalojnë të ardhurat, pasi në atë periudhë ZRPP ka qenë institucion tërësisht buxhetor.

- Për periudhën 2012-2019, të ardhurat tejkalojnë shpenzimet, pasi me ligjin e vitit 2012, ZRPP u kthye në institucion me vetë financim.

- Për periudhën 2019-2020 shpenzimet janë rritur shumë, pasi Institucionit i janë bashkuar funksione dhe institucione të tjera, të cilat që nuk krijojnë të ardhura dhe pa u shoqëruar me faturën financiare të tyre.

Të ardhurat gjatë vitit 2021 janë rritur me 30% më shumë krahasuar me të ardhurat e vitit të kaluar 2020.

Shënim: Të dhënat për vitin 2021 janë paraprake. Të dhënat e sakta dalin pas mbylljes së bilancit për sistemin e ASHK-së.

Situata aktuale financiare.

Gjatë vitit 2021 rezultoi një stok prej rreth 58,382 aplikimesh me vlerë fature rreth 36.707.900 lekë, shërbime të cilat janë ofruar nga ASHK dhe nuk janë paguar nga Institucionet përkatëse. Kjo vetëm për Institucionet për të cilat ligji parasheh procedurën e paspagimit, në zbatim të VKM-së Nr.389, datë 13.05.2020 "Për miratimin e listës dhe të tarifave të shërbimeve kadastrale", si dhe Ligjit Nr.111/2018 "Për Kadastrën".

Agjencia Shtetërore e Kadastrës ofron shërbime kadastrale për subjektet të cilat, sipas pikës 9 të VKM-së së sipërcituar, përjashtohen nga parapagimi i tarifave për shërbimet kadastrale, por që duhet t'i shlyejnë ato në muajin pasardhës.

Këtu përfshihen institucione si Prokuroritë, Gjykatat, Policia e Shtetit, sistemi i institucioneve të Vetingut, ILDKP (Autoriteti përgjegjës për deklarimin dhe kontrollin e pasurive), Autoriteti shtetëror përgjegjës për parandalimin e pastrimit të parave, Autoriteti përgjegjës për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara, etj.

Subjektet e përmendura në pikën 9, kanë shlyer pjesërisht detyrimin për shërbimet e ofruara nga ASHK në vlerën 13,811,400 lekë.

Rezulton se të ardhurat e munguara nga subjektet që përjashtohen nga parapagimi i tarifave për shërbimet kadastrale për vitin 2021, të jetë në total 22,896,500 lekë.

Megjithatë, për shkak se këto subjekte përdorin shërbimet kadastrale në kuadër të detyrës së tyre funksionale, drejtoritë vendore të ASHK-së kanë vazhduar të ofrojnë shërbimet kadastrale të kërkuara, megjithëse, këto subjekte nuk e kanë shlyer plotësisht shumën e tarifave të shërbimeve sipas faturave përkatëse për arkëtim të dërguara çdo muaj.

Problematikë mbetet fakti që shumë prej Institucioneve të tjera, për të cilat ligji parasheh procedurën e parapagimit, vijojnë të përdorin ende komunikimet shkresore për marrjen e shërbimeve kadastrale pa pagesë, në kundërshtim me Ligjin dhe Aktet Ligjore e Nënligjore. Këtu përfshihen gjithë institucionet e tjera, si Tatimet, Doganat, Avokati i Shtetit, ATP, Njësitë Vendore, Institucionet Qendrore, etj.

Për institucionet e tjera, për të cilat ligji parasheh procedurën e parapagimit, ky stok shërbimesh është shumë më i madh, duke shkuar në rreth 150.000 aplikime.

Këtu përfshihen gjithë institucionet e tjera, si Tatimet, Doganat, Avokati i Shtetit, ATP, Njësitë Vendore, Institucionet Qendrore, etj.

Përveç çështjes së pagesave, problem përbën edhe fakti që shumica e institucioneve, jo vetëm që nuk pranojnë të paguajnë shërbimin e kërkuar dhe të dhënë, por nga ana tjetër refuzojnë edhe të aplikojnë përmes platformës eAlbania, **duke vënë në dyshim zbatimin e reformës shumë të rëndësishme të Qeverisë së shërbimeve on-line.**

Koment: Mosshlyerja masive e detyrimeve për shërbimet e marra nga ana e të tretëve, krijon efekte negative në situatën financiare të agjencisë. **Kjo problematikë kërkon një trajtim emergjent (!!!).**

19. Sistemi i zyrave

Situata me godinat ku ishin vendosur zyrat e ZRPP në vitin 2019, **ishte shumë e keqe**. Një pjesë e konsiderueshme e drejtorive rajonale ishin të vendosura në ambiente private të mara me qira, një pjesë tjetër ishin vendosur në godina bashkërisht me institucione të tjera dhe vetëm një pjesë e vogël ishin vendosur në ambiente të vetat pavarësisht se edhe këto përgjithësisht të pamjaftueshme dhe në gjendje të keqe.

Me Bashkimin e institucioneve situata fillimisht u rëndua edhe më shumë.

Brenda dy viteve, **situata ka ndryshuar me themel**.

- Është përfunduar vendosja në godina të reja për 8 Drejtori Rajonale.
- Janë kaluar në pronësi të vetë institucionit shumica e zyrave të tjera që ende nuk kishin as dokumentacionin e pronësisë për vetë zyrat e veta.
- Janë në proces restaurimi 6 drejtori vendore.

	Drejtori në godina me qira:	Drejtori në godina të reja:	Godina të regjistruara
2019	7	0	4
2020	2	8	16
2021	5	0	18


Duhet pasur parasysh se përmirësimi i situatës së infrastrukturës së godinave të institucionit, ka lidhje direkte me:

- Përmirësimin e dinjitetit të shtetit;
- Përmirësimin e performancës dhe kushteve të punës së stafeve;
- Ruajtjen e arkivave të trashëguara dhe atyre që shtohen vazhdimisht.

Koment: Duke pasur parasysh rëndësinë e arkivave që administrojnë këto zyra në një shtet serioz, zyrat e kadastrës janë nga institucionet më të rëndësishme të shtetit.

QARKU:	Gjendja në momentin e krijimit të ASHK (2019)	Gjendja sot (2021):
Drejt. Përgj. ASHK	Stafi punon në godinën në përgjegjësi administrimi të ASHK-se dhe ambiente të tjera me qira	Në proces restaurimi nga tërmeti i 26 nëntorit 2019.
Tiranë	Stafi punon përkohësisht në ambiente me qira pranë TBP, në pritje të përfundimit të rikonstruksionit të ambienteve të Ish-ZRPP.	Në proces restaurimi nga tërmeti i 26 nëntorit 2019.
Kavajë	Ambiente me qira.	Vijojnë të punojnë në ambiente me qira.
Berat	Stafi punon në dy godina, njëra e ish ZVRPP dhe tjetra e Albtelecom, në kushte të vështira.	Vijojnë të funksionojë në dy godina të ndara. Është i domosdoshëm sigurimi i ambienteve të tjera.
Kuçovë	Punohet në ambientet e ish Zvrpp Kuçovë	Ambientet janë në gjendje të mirë.
Durrës	Stafi punon në ambiente me qira pranë TBP.	Punohet në ambiente me qira
Krujë	Stafi punon në ambiente me qira pranë TBP.	Punohet në ambiente me qira
Dibër	Punohet në godinën e Ish ZVRPP	Ambientet janë në gjendje të mirë
Elbasan	Stafi punon në godinë të re të kaluar në pronësi të ASHK-së.	Ambientet janë në gjendje të mirë
Fier	Stafi punon në godinë të vënë në dispozicion nga Bashkia, sipas një marrëveshje me të.	Vendosur në godinë të re, sipas një marrëveshje me Bashkinë.
Lushnje	Stafi punon në godinë të kaluar në pronësi të ASHK-së.	Ambientet janë në gjendje të mirë
Gjirokastrë	Stafi punon në godinë të kaluar në pronësi të ASHK-së.	Ambientet janë në gjendje të mirë
Tepelenë	Punohet në ambientet e ish ZVRPP	Ambientet janë në gjendje të mirë.
Korçë	Stafi punon në godinë të kaluar në pronësi të ASHK-së.	Ambientet janë në gjendje të mirë
Pogradec	Punohet në ambientet e Ish ZVRPP	Në gjendje relativisht të mirë.
Kukës	Punohet në ambientet e Ish ZVRPP, deri në rikonstruksionin e godinës së marrë në pronësi.	Në pritje të përfundimit të rikonstruksionit të godinës.
Lezhë	Stafi punon në ambientet e Ish-ZVRPP	Në gjendje të mirë.
Shkodër	Punohet në ambientet e Ish ZVRPP dhe 2 ambiente të marra me qira, në katin e parë të një pallati banimi, totalisht të papërshtatshme për zyra. Kjo ka vështirësuar funksionimin normal të kësaj drejtorie.	Është domosdoshmëri sistemimi i punonjësve në ambient tjetër të përshtatshëm shtetëror, dhe në pamundësi të gjetjes së tij, në ambient të marrë me qira
Vlorë	Stafi punonte në godinën e ish ZVRPP në pritje të rikonstruksionit të godinës së kaluar në pronësi	Në fazë prokurimi të rikonstruksionit të godinës.
Sarandë	Stafi punon në dy godina, njëra e ish ZVRPP dhe tjetra me qira, larg njëra tjetrës dhe që pengojnë funksionimin normal të punës në këtë drejtori.	Është domosdoshmëri sistemimi i punonjësve në ambient tjetër të përshtatshëm shtetëror, dhe në pamundësi të gjetjes së tij, në ambient të marrë me qira

PROCESI I PËRMIRËSIMIT HARTOGRAFIK




20- Procesi i përmirësimit/përditësimit të blloqeve kadastrale.

Përmirësim/përditësimi i blloqeve kadastrale.

Viti	Nr. Blloqe Kadastrale
2016	385
2017	139
2018	27
2019	21
2020	40
2021	104


Përmirësim/përditësimi i blloqeve kadastrale
2016-2021



Koment: Në vitet 2016,2017, numri i blloqeve kadastrale të përditësuara rezulton artificialisht i lartë, pasi në këtë shifër përfshihen dhe blloqet e përpunuara nga TAP (Trans Atlantic Pipeline). Pavarësisht se janë punuar nga punonjësit e TAP, konsideroheshin si blloqe të përmirësuar nga zyra vendore e ish ZVRP-së përkatëse.

21. Ecuria e procesit të Regjistrimit Fillestar.


Viti	Numri i pasurive të përfshira në regjistrimin fillestar
2015	21,500
2016	60,836
2017	30,808
2018	34,517
2019	62,162
2020	28,553
2021	23,521



22. Ngarkimi i pasurive në sistemin ALBSCAD.

Tabela e mëposhtme paraqet ecurinë në vite të pasurive të ngarkuara në sistemin elektronik të pasurive të paluajtshme ALBSReP.

Viti	Nr. pasurive të ngarkuara në sistem
Para vitit 2014	227,445
2014	240,434
2015	240,590
2016	283,061
2017	237,906
2018	173,342
2019	197,905
2020	114,700
2021	164,246



Koment: Në krahasim me vitet paraardhëse, në vitin 2020 ka një rënie të theksuar të numrit të pasurive të ngarkuara në sistem. Kjo ndodh themelisht prej faktit që në vitet paraardhëse numri i pasurive të ngarkuara në sistem ka qenë vërtet i madh, por saktësia e tyre ka qenë shumë e ulët (raporti i VBB sipas të cilit 80% e pasurive duhen rimatur). Në ndryshim prej tyre, **pasuritë e ngarkuara në sistem në vitin 2020 dhe 2021, janë me saktësi të lartë** dhe nuk kanë nevojë për saktësime shtesë. Ndërsa gjatë vitit 2021 numri i pasurive të ngarkuara në sistem është rritur me 43% në krahasim me vitin 2020.

RISITĚ



23. Risitë e Vitit 2022.

Gjatë vitit 2022, në fushën e digjitalizimit të ASHK-së synohet:

Nr.	RISIA	EFEKTI QË SJELL
1.	Implementimi i projektit "Digjitalizimi i Kadastrës", Janar 2022-Dhjetor 2023.	- Skanimi i dokumentacionit të referencave, për rreth 56 milion dokumente; - Skanimi dhe digjitalizimi i kartelave të pasurisë për rreth 3,3 milion kartela pasurie (nga 4 milion pasuri që janë në total). - Efekti fundor, realizimi i shprehjes së Kryeministrit: "Brenda 1 minute të më vijë dokumenti në telefon".
2.	Lëvrimi i të gjitha shërbimeve kadastrale vetëm elektronikisht në formatin digjital	- Kontroll dhe verifikim në kohë reale i dokumenteve të lëshuar.
3.	Implementimi i 10 shërbimeve të reja elektronike kadastrale dhe jo vetëm.	- Rritje të gamës së shërbimeve që ofron ASHK.
4.	Krijimi i protokollit elektronik të komunikimit me qytetarët për legalizimet	- Vendosja e radhës elektronike të shërbimit; - Standardizimi i procedurave të aplikimeve të reja deri në përgjigjen finale, ku çdo shërbim i dhënë nga ASHK do të njoftohet nëpërmjet mail dhe sms gateway.
5.	Inventarizimi i aplikimeve ekzistuese për legalizimet dhe krijimi i një regjistri inventarizues	- Vendosje në rend të të gjithë aplikimeve dhe shqyrtimin e tyre ; - Ezaurimi i pretendimeve mbi regjistrimet e mëparshme.
6.	Dhënie përgjigje vetëm nëpërmjet modulit ASHK për Institucione, për të gjitha institucionet.	- Ulje të burokracive; - Rritje të cilësisë së shërbimit të ASHK ndaj entiteteve publike.
7.	Shërbime të përshpejtuara për qytetarët dhe bizneset, sipas një liste të cilësuar.	- Reduktim i kohës së dhënies së shërbimit në 24 orë, nga momenti i konfirmimit të pagesës; - I gjithë procesi i qarkullimit të dokumenteve do të jetë vetëm elektronik.
8.	Krijimi i skedarit elektronik të çështjeve juridike për ASHK.	- Evidentimin dhe konsolidimin e shtresëzimeve të fakteve duke dhënë prioritizimin dhe argumentimin.

9.	Vendosja e kufizimeve në sistem për radhën e veprimet dhe transparencën e shërbimeve të dhëna për qytetarët.	<ul style="list-style-type: none"> - Rritjen e transparencës së shërbimeve të dhëna për qytetarët; - Ndarjen e aplikimeve në mënyrë inteligjente elektronike; - Zbatimin me rigorozitet nga ana e specialistëve të radhës së shpërndarjes; - Eliminimin e përzgjedhjeve preferenciale mbi aplikimet; - Çdo specialist, mund të përpunojë informacionin q vjen në mënyrë elektronike nga portali e-albania, për të gjithë Shqipërinë; - Garantohet mosnjohja e qytetarit dhe specialistit.
10.	Riinxhinierim i procedurave të brendshme.	<ul style="list-style-type: none"> - Çështjet shkojnë tek specialistët sipas një konfigurimi të caktuar dhe me load balancing; - Nuk ka më specialistë të caktuar, zona të caktuara.
11.	Rritja e kapaciteteve dhe përmirësimi i infrastrukturës hardware,	<ul style="list-style-type: none"> - Përafrimi i data bazës shtetërore të pronës në nivelin e sigurisë D3/I3/K3 (disponueshmëria, integriteti dhe konfidencialiteti).
12.	Përmirësimi, monitorimi, ristrukturimi i network për ASHK.	<ul style="list-style-type: none"> - Rritja e kapaciteteve të sigurisë së informacionit; - Rritja e nivelit të sigurisë për të gjithë përdoruesit e sistemit të ASHK-së; - Mbrojtja nga sulmet e brendshme dhe të jashtme.
13.	Sistem Monitorimi të riskut	<ul style="list-style-type: none"> - Parandalimin e veprimeve keqdashëse nga punonjësit e brendshëm; - Parandalimin e veprimeve keqdashëse nga sulmet e jashtme kibernetike.
14.	Arkivimi i regjistrave të përfituesve të tokës bujqësore në Prefektura/Bashki	<ul style="list-style-type: none"> - Digjitalizimi i gjithë informacionit; - Mundëson kryqëzimin e të dhënave me informacionin e hedhur në ASHK ndër vite, si dhe atë të pa hedhur.
15.	Krijimi i modulit të vlerës së pronës.	<ul style="list-style-type: none"> - Automatizimin e vlerës së pronës; - Automatizimin e të gjitha hallkave të procesit që lidhen me vlerën e pronës; - Standardizimin e formularit të rivlerësimit; - Konfirmimin e formularit të rivlerësimit tek qytetari në kohë reale; - Rritjen e interoperabilitetit me bankat e nivelit II dhe platformën GG-payment, me qëllim konfirmimin në kohë reale të pagesës për shërbimet e kërkuara; - Lëshimin e certifikatës, kartelës dhe hartës për të gjitha pronat e certifikuar nga ASHK në kohë reale.